



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Projekt Vendimi Nr.4
dt.17 .08.2022

Mbi
Dhënien e ndihmës financiare familjeve të dëmtura nga zjarri për vitin
2021 & 2022.

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore” i ndryshuar ,Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”,Vendimi Nr.414 dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr 72 dt.23.12.2021“Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2022”, i konfirmuar nga Prefektura me shkresën Nr.12/1 dt.14.01.2022,

Përsa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në banesat e tyre që janë banorë të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare prej **708.442** (shtatëqind e tetë mijë e katërqind e katërdhjetë e dy) lekë për **1** (një) shtetas të Bashkisë Vau-Dejës të dëmtuar nga zjarri gjatë vitit 2021 në totalin e vlerës së mbetur të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij si me poshte:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa	Vlera Totale e Demit	Traj.sipas VKB Nr/ date	Shuma e kaluar Sipas VKB 30%	Shuma e per tu paguar me Trans.Kusht. ne leke	Shuma per tu paguar me fondet tona
1	Nikolin	Dod	Hiluku	Nj.Admin. Vau-Dejes	6.691.126	VKB Nr.52 dt.26.08.2021 konf.shkr.610/1 dt.10.09.2021	2.007.338	3.975.346	708.442
Shuma									708.442

2. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare prej **1.399.326** (Një milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e gjashtë) lekë për 1 (një) shtetas të Bashkisë Vau-Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia gjatë vitit 2022, në zbatim të nënit 41 të Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, si më poshtë vijon:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa	Vlera Totale e Demit	Traj.sipas VKB Nr/ date	Shuma e kaluar Sipas VKB 30%	Shuma e per tu paguar ne leke me buxhetin e planifikuar
1	Nikoll	Zef	Pecaj	Nj.Admin.Vig Mnele		VKB Nr.15 dt.28.03.2022 konf.shkr.225/1 dt.14.04.2022	1.399.326	1.399.326
Shuma								1.399.326

3. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare në shumën totale prej **2.107.768** (Dymilion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë për 2(dy) shtetasit e Bashkisë Vau-Dejës banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri gjatë viteve 2021 & 2022.

4. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banoreve të dëmtuar.

5. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i planifikuar në programin “Mbrojtja Civile “i cili është miratuar në buxhetin e vitit 2022 në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr 72 dt.23.12.2021 “Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2022.

Konfirmoi bazwn ligjore

Kristine SHTATRI

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

KRYETARI

Mark BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 4/1 Prot.

Vau Dejës, me 17/08 2022

RELACION

Per miratimin e pjesës së mbetur të kompensimit familjes së dëmtuar nga zjarri gjatë vitit 2021 dhe 30% të vlerës së dëmit për familjen e dëmtuar gjatë vitit 2022

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

VKM nr.329 dt.16.05.2012”Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore pika 1 thuhet: ” *Shteti ndihmon financiarisht të dëmtuarit, në rastet kur , si rezultat i fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore , kanë pësuar dëmë ne njëri dhe dëmë në materiale në kushtet kur për përballimin e situatës :*

a. Është shpallur gjendja e emergjencave civile

b. Nuk është shpallur gjendja e emergjencave civile

Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burime financiare si: *të ardhurat vendore, nga fondet që ju vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare , huamarrja vendore , donacionet, burime te tjera të parashikuar në ligj.*

Në ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, Neni 41 pika 2 thuhet: “*Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia , nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile” si dhe pika 3 thuhet: “Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitet pasardhëse , deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara.*

Gjatë vitit 2021 është djegur 1(njw) banese e cila është trajtuar sipas VKB Nr 52 datë 26.08.2021 në masën 30% të vlerës totale të dëmit .Në projekt vendimin nr.3 dt.17.08.2022 është menduar të trajtohet në masën e 59% të vlerës totale të dëmit nga akordimi i fondit te kushtëzuar me shkresën e Agjensise Kombëtare të mbrojtjes Civile” nr.1007/1 dt.17.06.2022 , i cili nuk e mbulon vlerën totale të dëmit. Në projekt vendimin Nr.4 është parashikuar dhënia e 11% të vlerës së mbetur të dëmit në shumën 708.442 (shtatëqind e tetëmije e katërqind e katërdhjetë e dy) nga fondi i planifikuar në programin “Mbrojtja Civile” i cili është miratuar ne Buxhetin e Vitit 2022 sipas VKB Nr.72 dt.23.12.2021 “Mbi miratimin e Buxhetit të vitit 2022” .

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa	Vlera Totale e Demit	Traj.sipas VKB Nr/ date	Shuma e kaluar Sipas VKB 30%	Shuma e per tu paguar me Trans.Kusht. ne leke	Shuma per tu paguar me fondet tona
1	Nikolin	Dod	Hiluku	Nj.Admin. Vau-Dejes	6.691.126	VKB Nr.52 dt.26.08.2021 konf.shkr.610/1 dt.10.09.2021	2.007.338	3.975.346	708.442
Shuma									708.442

Gjatë vitit 2022 është djegur 1 (një) banesë cila është trajtuar sipas VKB Nr.15 dt.28.03.2022 në masën 30% të vlerës totale të dëmit. Në projekt vendimin nr.4 parashikojmë dhënien e ndihmës financiare në masën 30% në shumën 1.399.326 (Njëmilion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e gjashtë) nga fondi i planifikuar në programin “Mbrojtja Civile” i cili është miratuar ne Buxhetin e Vitit 2022 sipas VKB Nr.72 dt.23.12.2021 “Mbi miratimin e Buxhetit të vitit 2022” bazuar në ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, Neni 41 pika 2 thuhet: “Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia , nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile” si dhe pika 3 thuhet: “Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitet pasardhëse , deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara” .


Bazuar në nenin 41 pika 2 kompensimi i plotë për këtë familje do të planifikohet për vitet pasardhëse deri ne masën 100%.

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa	Vlera Totale e Demit	Traj.sipas VKB Nr/ date	Shuma e kaluar Sipas VKB 30%	Shuma e per tu paguar ne leke me fondet tona
1	Nikoll	Zef	Pecaj	Nj.Admin.Vig Mnele		VKB Nr.15 dt.28.03.2022 konf.shkr.225/1 dt.14.04.2022	1.399.326	1.399.326
Shuma								1.399.326

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit Nr.4 dt.17.08.2022

Përgjegjësi i Emergjencave Civile

Valjeta NIKAJ



KRYETARI I BASHKISË

Mark BARANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 225/1 prot.

Shkodër, më 14.04.2022

Nr. 1971/1 Prot

Dt. 20.04.22



Lënda: Mbi Vendimin nr. 15, datë 28.03.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja “dh”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, të VKB Vau Dejës nr. 72, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Vau Dejës”, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 1967 prot., datë 04.04.2022 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 28.03.2022”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 15, datë 28.03.2022 “Për dhënie ndihmë financiare familjes së z. Nikoll Pecaj që është i dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë, referuar Vërtetimit të MZSH nr. 2, datë 28.02.2022”, me ndihmë financiare z. Nikoll Pecaj në shumën prej 1.399.326 lekë, me burim financimi programi 3280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” i buxhetit të vitit 2022 Bashkia Vau Dejës.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin, por gjatë zbatimit të dëmtuarit duhet t’i jepet ndihma financiare sipas përcaktimit të Kreut III, pika 3, shkronja “ç” e VKM 329/2012, në të cilën citohet se dëmshpërblimi duhet të jetë 50% e vlerës së llogaritur të dëmit të vlerësuar nga komisioni i emergjencave civile.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M
Nr. 15 datë 28.03 2022

**Dhënie ndihme financiare familjes së z.Nikoll Pecaj që i është dëmtuar banesa si
pasoje e zjarrit të rene me dt.24.02.2022**

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Vendimi Nr.414 dt.08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriteret e ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile", Udhëzimi nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave , për vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.72 dt.23.12.2021 "Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2022"konfirmuar nga Prefektura Shkoder me shkresën Nr.12/1 dt.14.01.2022,si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.1 dt.16.03.2022, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasin **Nikoll Pecaj** banorë i fshatit **Mnelë e madhe** të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës:

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilësuar votash,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:**

1. **Miratimin** e proces verbalit të konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve,relacionit teknik të hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e kryetarit te Bashkisë Nr.79 prot dt.01.03.2022 në vlerën totale **4.664.421**(Katërmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katërmije e katërqind e njëzet e një) lekë për shtetasin **Nikoll Pecaj** banorë i fshatit **Mnelë e madhe** të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës .
2. **Miratimin** e dhënies së ndihmës financiare për shtetasin **Nikoll Pecaj** banorë i fshatit **Mnelë e madhe** të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **1.399.326** (Njëmilion e treqind e nentëdhjetë e nëntëmije e treqind e njëzet e gjashtë) lekë në masën 30% të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia e saj me dt.24.02.2022.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
4. **Burimi i financimit :**Fondi i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në Buxhetin e Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.72 dt.23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022.
5. Ngarkohen Drejtorja e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

KRYETAR

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Arduan Çelepi



Miratuar me 20 vota

Vota Pro 18

Vota Kunder 1 (140)

Vota Abstenim 1 (140)

Zbardhur me datë 04/04/2022